

VENDIM
Nr. 37, datë 1.12.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.12.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Dh) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi i fjalisë së dytë në pikën 8, të nenit 10, të ligjit nr. 32/2021, datë 16.3.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me përmbajtjen “Pala e dëmtuar ose përfituesi, në rast se merr shërbime nga mbrojtësi ligjor, mund t’i paguhet deri në 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar, por jo më pak se tarifat e përcaktuara në aktet përkatëse”, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 49, 131, pika 1, shkronja “c”, 134 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtimet e kërkuases, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*) dhe Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, mendimet me shkrim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 32/2021, datë 16.3.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (ligji nr. 32/2021). Ky ligj rregullon sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit (neni 1), duke përfshirë sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit të transportit (mjet motorik, mjet lundrues dhe avion) për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtyre mjeteve, si dhe sigurimin e

pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik (*neni 2*). Në nenin 10 të tij përcaktohen procedurat, përfshirë afatet, për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria siguruese gjer në njoftimin e palës së dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar ose për shkaqet ligjore të refuzimit.

2. Në datën 12.7.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të fjalisë së dytë të pikës 8 të nenit 10 të ligjit nr. 32/2021, e cila ka këtë përmbajtje: “*Pala e dëmtuar ose përfituesi, në rast se merr shërbime nga mbrojtësi ligjor, mund t’i paguajë deri në 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar, por jo më pak se tarifat e përcaktuara në aktet përkatëse.*” (*dispozita ligjore e kundërshtuar*).

3. Kolegji i Gjykatës në datën 16.9.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Gjithashtu, Kolegji ka vlerësuar të marrë mendim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve, të drejtat kushtetuese të përfshira, si dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe në atë të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

4. Në datën 26.9.2022 në Gjykatë është regjistruar kërkesa e Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë për të marrë pjesë si subjekt i interesuar në gjykimin kushtetues të çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, duke marrë në konsideratë qëllimet e veprimtarisë së shoqatës, me vendimin e datës 27.9.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës, me arsyetimin se pjesëmarrja e saj i shërben gjykimin kushtetues.

5. Kërkesja e ka paraqitur kërkesën e saj nën emërtimin “Dhoma Kombëtare e Avokatisë”, të cilit i referohet edhe në përmbajtje të kërkesës. Gjykata, duke konsideruar faktin se me ligjin nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 55/2018*) emërtimi i saj ka ndryshuar, në tekstin e këtij vendimi do t’i referohet emërimit të ri ligjor - “Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë”.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se dispozita ligjore e kundërshtuar cenon:

6.1 *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi kufizon shpërblimin që përfitojnë mbrojtësit ligjorë kur përfaqësojnë të dëmtuarit ose përfituesit nga kontratat e sigurimit të mjeteve motorike në masën “*deri në 5% të vlerës së dëmshpërblimit*”. Ky kufizim, në shkelje të nenit 17 të Kushtetutës, nuk justifikohet nga ndonjë interes publik dhe, për rrjedhojë, nuk është proporcional.

6.2 *Parimin e mosdiskriminimit në marrëdhëniet ekonomike*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj. Dispozita ligjore e kundërshtuar parashikon shpërblimin e avokatëve që përfaqësojnë çështje të sigurimit sipas ligjit nr. 32/2021 deri në 5% të masës së dëmshpërblimit, në ndryshim nga avokatët që përfaqësojnë çështje të tjera, për të cilët nuk ka kufizime të tilla në ligjin për profesionin e avokatit. Ky trajtim i ndryshëm nuk justifikohet nga ndonjë interes publik, si dhe nuk konsideron kompleksitetin e çështjeve dhe shpenzimet eventuale të avokatit, duke rrezikuar të pamundësojë ndihmën ligjore të të dëmtuarve ose përfituesve të dëmshpërblimit.

7. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

7.1 Kërkesja *nuk legjitimohet* për të vënë në lëvizje Gjykatën, pasi nuk justifikon interesin në kuptim të qëllimit të veprimtarisë së saj. Ajo, në kushtet kur parashikimet ligjore preknin fushën e veprimtarisë së saj, ka pasur mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e projektligjit.

7.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë ekonomike* nuk qëndron, pasi neni 10, pika 8, i ligjit nr. 32/2021 nuk prek lirinë e mbrojtësit për të negociuar me palën e dëmtuar. Dispozita ka për qëllim që

dëmshpërblimi të shkojë te rrethi i përfituesve të përcaktuar nga ligji. Pretendimi se kufizimi nuk është *proporcional dhe i nevojshëm*, është i pabazuar. Kufizimi është i vendosur me ligj, nuk është arbitrar, është i përshtatshëm, i arsyeshëm dhe nuk cenon të drejtën e mbrojtësit për t'u shpërblyer për punën e kryer, si dhe mbron interesat e përfituesve të dëmshpërblimit nga tarifat abuzuese të mbrojtësve. Dëmshpërblimi synon riparimin proporcional të dëmit që iu është shkaktuar të dëmtuarve dhe kufizimi i shpërblimit të mbrojtësit është në funksion të mbrojtjes së kësaj të drejte.

8. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

8.1 Kërkuesja *nuk legjitimohet*, pasi neni 10, pika 8, fjalia e dytë, i ligjit nr. 32/2021 nuk justifikon interesin e saj në kuptim të qëllimit të veprimtarisë së saj. Nuk plotësohet as kriteri i legjitimitetit *ratione materiae*, pasi dispozita e kundërshtuar është në përputhje me Kushtetutën. Synimi i ligjbërësit, ndër të tjera, ka qenë shmangia e rasteve abuzive në procesin e dëmshpërblimit.

8.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë ekonomike* është i pabazuar, pasi shpërblimi i avokatëve përcaktohet nga ligji nr. 55/2018. Norma e kundërshtuar nuk lejon avokatin të marrë mbi 5% të vlerës së dëmshpërblimit për të ndaluar abuzimin në funksion të shtetit social që mbron qytetarin. Ajo synon që dëmshpërblimi të ketë si destinacion final përfituesin e dëmtuar dhe jo mbrojtësit. *Parimi i proporcionalitetit* sipas nenit 17 të Kushtetutës nuk është cenuar. Objektivi i ligjvënësit justifikon kufizimin e së drejtës; masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk janë arbitrare, të padrejta ose të bazuara në vlerësime alogjike; mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar.

8.3 Pretendimi se dispozita ligjore nuk respekton *parimin e mosdiskriminimit*, sipas nenit 18 të Kushtetutës, është i pabazuar. Vlerat e shpërblimit të avokatit, edhe pse me tavan, janë shumë herë më të larta sesa tarifat e miratuara nga kërkuesja dhe Ministria e Drejtësisë. Për më tepër, kërkuesja nuk provon lidhjen e drejtpërdrejtë, qoftë edhe në terma sasiorë, midis dëmit ekonomik të pretenduar prej saj dhe vlerës 5% të dëmshpërblimit të përfituar.

9. **Subjekti i interesuar, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1 Kërkuesja *nuk legjitimohet*, pasi jo vetëm nuk ka paraqitur drejt thelbin e rregullimit të normës ligjore, por nuk ka paraqitur as argumente të nivelit kushtetues. Kërkuesja, për mënyrën e shpërblimit të avokatit, i referohet një ligji të shfuqizuar.

9.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë ekonomike* nuk qëndron, pasi dispozita e kundërshtuar mbron destinacionin e shumës së dëmshpërblimit, ndërsa tarifat për shërbimin e avokatit rregullohen nga ligji nr. 55/2018. Pretendimi se kufizimi nuk respekton *parimin e proporcionalitetit* është i pabazuar, pasi mbështetet në vlerësimin e njëanshëm të kërkueses. Llogaritja e dëmshpërblimit nuk konsideron masën e shpërblimit të avokatit. Balanca e të drejtave në testin e proporcionalitetit duhet të përmbajë të drejtat ekonomike të avokatit, nga njëra anë, dhe të drejtat e jetës, ekonomike, shëndetësore, ekzistenciale e morale të klientit, në anën tjetër. Mbrojtja e të dyve është interes i rëndësishëm publik, ndaj masa 5% është garanci mbrojtëse e të dëmtuarit.

9.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit* është i pabazuar, pasi neni 16 i ligjit nr. 55/2018 parashikon mënyra të tjera të caktimit të shpërblimit të avokatit. Argumenti i kërkueses për këtë pretendim është i paqartë dhe e bën të pamundur testin e mosdiskriminimit. Nuk ka ndarje klasash ose grupesh mes avokatësh, pasi të gjithë avokatët mund të ndjekin çështjet në fushën e sigurimeve. Kërkuesja nuk argumenton nëse diskriminimi gjen ose jo justifikim të arsyeshëm, nëse është masë e veçantë e bazuar apo jo në ligj, si dhe për formën që është ushtruar ky diskriminim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000, të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, e kanë edhe organizatat, të cilat janë subjekt i kushtëzuar, në kuptimin që duhet të justifikojnë interesin e tyre për çështjen e parashtruar.

11. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Subjekti i kushtëzuar që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së tij dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë kundërshtuar legjitimitetin e kërkueses me argumentin se objekti i veprimtarisë së saj nuk lidhet me dispozitën ligjore të kundërshtuar e, për pasojë, nuk rregullon asnjë marrëdhënie që është qëllim i veprimtarisë së saj. Mbrojtja e interesave për shpërblimin që përfitojnë avokatët për shërbimet e tyre nuk është përcaktuar në qëllimet e statutit të saj. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka kërkuar që kërkuesja të mos legjitimohet në këtë gjykim me argumentin se ajo ka pasur mundësinë për t’u njohur në kohë dhe për të kontribuar në përmirësimin e projektligjit, duke pranuar në këtë mënyrë se dispozita ligjore e kundërshtuar prekte fushën e veprimtarisë së kërkueses.

13. Edhe subjekti tjetër i interesuar, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, ka prapësuar se kërkuesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën në kushtet kur ajo ka kundërshtuar në tërësi normën ligjore, duke heshtur qëllimisht ndaj pjesës së dytë të fjalisë “*por jo më pak se tarifat e përvaktuara në aktet përkatëse*”, që përbën thelbin e rregullimit. Sipas saj, në kërkesë mungojnë argumentet e nivelit kushtetues. Kërkuesja, për mënyrën e shpërblimit të avokatit, i referohet në argumentet e saj ligjit të shfuqizuar të avokatisë dhe jo ligjit nr. 55/2018 që është në fuqi.

14. Gjykata e ka analizuar edhe më parë çështjen e legjitimitetit të kërkueses në kërkesa të kontrollit abstrakt të normës ligjore, duke konstatuar se, sipas statutit, kërkuesja është bashkim i anëtarëve aktivë dhe pasivë të dhomave vendore të avokatisë (*neni 1*), që ka për objekt të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, garantimin e ushtrimit të profesionit dhe forcimin e pavarësisë së avokatit si një profesionist i lirë, si dhe mbrojtjen e avokatëve nga qëndrimet arbitrare ose çdo formë presioni publik ose privat, që synon të cenojë pavarësinë e profesionit të tyre (*neni 3*). Nisur nga lidhja që ekzistonte ndërmjet objektit të veprimtarisë së kërkueses dhe çështjes së paraqitur për shqyrtim, Gjykata ka vlerësuar se ajo legjitimohej *ratione personae* në paraqitjen e kërkesës dhe vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues (*shih vendimet nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 7, datë 12.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkuesja nëpërmjet organeve të saj të brendshme, bazuar në ligjin nr. 55/2018, i cili normon organizimin dhe funksionimin e profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë, ka kompetencë të garantojë dhe mbrojë me të gjitha mjetet ligjore të drejtat dhe interesat e avokatëve dhe të dhomave vendore të avokatisë, në raport me njëra-tjetrën dhe ndërmjet tyre dhe gjykatave, prokurorive dhe organeve publike (*shih nenin 27, pika 3, shkronja “j”, të këtij ligji*). Në kushtet kur shpërblimi i avokatëve për punën e kryer lidhet drejtpërdrejt me interesat e tyre, kërkuesja ka tagrin që nëpërmjet kundërshtimit të dispozitës ligjore, e cila cakton një mënyrë të shpërblimit të

avokatëve në një fushë specifike, të kërkojë me çdo mjet ligjor mbrojtjen e interesave të tyre. Për rrjedhojë, në ndryshim nga sa pretendojnë subjektet e interesuara, çështja e parashtruar përpara Gjykatës përfshihet në qëllimet e veprimtarisë së kërkueses.

16. Gjithashtu, Gjykata evidenton se prapësimi i subjektit të interesuar, Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, për mungesën e legjitimitetit të kërkueses me argumentin se ajo ka shmangur thelbin e rregullimit të dispozitës ligjore të kundërshtuar, parimisht nuk pengon legjitimitetin e saj, pasi ky argument ka lidhje me themelin e çështjes. Po kështu, fakti që kërkuesja i është referuar në argumentet e saj një ligji të shfuqizuar, nuk përbën problem kushtetues, në kushtet kur thelbi i pretendimeve ka natyrë kushtetuese dhe referimi është bërë për qëllim të analizës së paraqitur prej saj. Ndërsa, lidhur me faktin se kërkuesja e kishte mundësinë për t'u njohur në kohë dhe për të kontribuar në përmirësimin e projektligjit gjatë fazës së shqyrtimit të tij, Gjykata vëren se nenet 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pikat 1, shkronja "h" dhe 2, të Kushtetutës të lidhura me nenin 49, pikat 3, shkronja "d" dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, nuk vendosin si kusht legjitimiteti të subjektit të kushtëzuar pjesëmarrjen dhe kontributin gjatë fazës së hartimit të ligjit që kundërshtohet prej saj.

17. Për sa më lart, në kushtet kur dispozita ligjore e kundërshtuar lidhet me qëllimet e veprimtarisë së kërkueses, siç pranon edhe vetë subjekti i interesuar, Kuvendi, Gjykata vlerëson se ajo justifikon interesin e saj të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar në kuptim të nenit 131, shkronja "a", të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja "d", të ligjit nr. 8577/2000, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

18. Në vijim, Gjykata, bazuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, çmon se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 32/2021. Konkretisht, ligji nr. 32/2021 është botuar në Fletoren Zyrtare dhe sipas nenit 61 të tij ka hyrë në fuqi në datën 1.7.2021, ndërsa kërkesa për kontroll kushtetues për një prej dispozitave të tij është paraqitur në datën 12.7.2022.

19. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të proporcionalitetit dhe parimit të mosdiskriminimit në marrëdhëniet ekonomike të avokatëve, të garantuara respektivisht nga nenet 11, 17 dhe 18 të Kushtetutës. Këto pretendime hyjnë në juridiksionin kushtetues, prandaj Gjykata në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike

20. Kërkuesja ka pretenduar se dispozita ligjore e kundërshtuar i ka cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, për shkak të kufizimit të shpërblimit "*deri në 5% të vlerës së dëmshpërblimit të përfituar*" të mbrojtësit ligjor që përfaqëson të dëmtuarit ose përfituesit nga kontratat e sigurimit të mjeteve motorike. Liria ekonomike, në rastin e avokatëve, përfshin edhe të drejtën për të negociuar dhe vendosur lirisht çmimet e shërbimeve ose kontratave dhe është e mjaftueshme që kjo liri të mos cenojë interesa të ligjshme të shoqërisë apo qytetarëve të tjerë. Sipas kërkueses, kufizimi i masës së shpërblimit, në shkellje të nenit 17 të Kushtetutës, nuk justifikohet nga ndonjë interes publik dhe, për rrjedhojë, nuk është proporcional. Në rastin e një marrëveshjeje mes klientit dhe avokatit nuk vihet në diskutim asgjë publike, përveç detyrimeve deontologjike dhe ligjore të avokatit. Kufiri 5 % i masës së shpërblimit është i paarsyeshëm dhe i panevojshëm në raport me objektivin publik që synohet të arrihet. Kërkuesja parashtron, gjithashtu, se nga përmbajtja e relacionit shoqërues të projektligjit vihet re mungesa e arsytimit mbi pasojën e kësaj norme, nevojën publike të këtij kufizimi dhe vlerësimin proporcional mes interesit publik që synohet të mbrohet dhe nivelit të kufizimit që do të vendoset, apo pse është vendosur ky nivel kufizimi dhe pse nuk është i përshtatshëm një nivel tjetër kufizimi.

21. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se neni 10, pika 8, i ligjit nr. 32/2021 nuk cenon lirinë e mbrojtësit për të negociuar me palën e dëmtuar. Qëllimi i dispozitës është që dëmshpërblimi të shkojë te rrethi i subjekteve të parashikuara në ligj. Referuar nenit 25 të ligjit, vlera 5 % e shumës

së dëmshpërblimit është shumë herë më e lartë sesa tarifat e miratuara nga kërkuesja dhe Ministria e Drejtësisë. Sipas pikës 9 të nenit 25 të po këtij ligji, për kontratat e lidhura në periudhën 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2026 kufiri minimal do të rritet, që do të thotë se do të rritet edhe masa e shpërblimit të mbrojtësit. Gjithashtu, i pabazuar është edhe pretendimi se kufizimi është disproporcional dhe i panevojshëm, pasi ai është i vendosur me ligj, nuk është arbitrar, është i përshtatshëm, i arsyeshëm dhe nuk cenon të drejtën e mbrojtësit për t'u shpërblyer për punën e kryer, si dhe mbron interesat e përfituesve të dëmshpërblimit nga tarifat abuzuese të mbrojtësve. Gjatë konsultimit publik të projektligjit u konstatua se pagesat për mbrojtësit ishin mbi 50% të masës së dëmshpërblimit që merrnin përfituesit. Dëmshpërblimi synon riparimin proporcional të dëmit që i është shkaktuar të dëmtuarve dhe kufizimi i shpërblimit të mbrojtësit është në funksion të mbrojtjes së të drejtës të të dëmtuarve për të gëzuar masën e dëmshpërblimit.

22. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, neni 10, pika 8, fjalë e dytë, i ligjit nr. 32/2021 është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, pasi kufizimi është i nivelit ligjor, ekziston interesi publik, ka proporcionalitet mes mjetit dhe qëllimit, si dhe nuk prek thelbin e së drejtës. Ai nuk ndalon avokatin të lidhë marrëveshje sipas ligjit nr. 55/2018, por nuk lejon avokatin të marrë mbi 5% të vlerës së dëmshpërblimit për të shmangur abuzimin në funksion të shtetit social që mbron qytetarin. Përcaktimi me ligj i shpërblimit të avokatit është në përputhje me një nga mënyrat e caktimit të shpërblimit të parashikuara nga neni 16 i ligjit nr. 55/2018. Norma e kundërshtuar është në përputhje me parimin e ligjshmërisë, nuk cenon parimin e sigurisë juridike ose të lirisë ekonomike të kërkueses, si dhe përmbush rekomandimet e Komisionit Evropian për mbrojtjen e konsumatorit dhe përafrimin e legjislacionit me të drejtën komunitare. Objektivi i ligjvënësit është i rëndësishëm dhe justifikon kufizimin e së drejtës; masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk janë arbitrare, të padrejta ose të bazuara në vlerësime alogjike; mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar. Nisma ligjore ka adresuar praktikën abuzive në të cilat të dëmtuarit janë tarifuar nga mbrojtësit me shuma të konsiderueshme, të llogaritura si përqindje mbi dëmshpërblimin e përfituar. Qëllimi i dispozitës është që dëmshpërblimi të ketë si destinacion final përfituesin e dëmtuar dhe jo mbrojtësin. Masa e shpërblimit nuk cenon të drejtën e avokatit të kërkojë shpenzimet gjyqësore të parapaguara prej tij, sipas nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile.

23. Edhe subjekti tjetër i interesuar, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, ka prapësuar se dispozita e kundërshtuar mbron destinacionin e shumës së dëmshpërblimit, ndërsa tarifat për shërbimin e avokatit rregullohen nga ligji nr. 55/2018. Shoqëritë e sigurimit kanë konstatuar se para miratimit të ligjit, 30–40% nga shuma e dëmshpërblimit shkonte në favor të avokatit. Vlerat e larta të shpërblimit të avokatit ulin masën e dëmshpërblimit dhe prishin balancën e drejtë që duhet të ekzistojë në gëzimin e shumës që akordohet. Sipas përlllogaritjeve të shoqatës, me zbatimin e ligjit të ri çështjet zgjidhen me mirëkuptim dhe më pak se 1% e tyre janë paraqitur në gjykatë. Parashikimi ligjor për shpërblimin e mbrojtësit është një masë e arsyeshme. Norma ligjore nuk është pengesë për marrëveshjen midis palëve për shpenzimet e çështjes. Risku që merr avokati për të ndjekur çështjen, duke përballuar vetë shpenzimet, nuk është argument për të përfituar nga dëmshpërblimi deri në dëmtimin e interesave të klientit. Pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar dhe i gabuar, pasi mbështetet në një vlerësim të njëanshëm të kërkueses. Llogaritja e dëmshpërblimit nuk merr në konsideratë masën e shpërblimit të avokatit. Balanca e të drejtave në testin e proporcionalitetit do të përmbajë të drejtat ekonomike të avokatit nga njëra anë dhe të drejtat e jetës, ekonomike, shëndetësore, ekzistenciale e morale të klientit nga ana tjetër. Mbrojtja e të dyve është interes i rëndësishëm publik, për këtë arsye masa 5% është garanci për të dyja palët dhe mbron të dëmtuarin.

24. Neni 11 i Kushtetutës parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Sipas pikës 3 të

këtij neni, kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.

25. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Pretendimi për cenimin ose jo të lirisë së veprimtarisë ekonomike, krahas kritereve “vetëm me ligj” dhe “vetëm për arsye të rëndësishme publike”, të përcaktuara në nenin 11, pika 3, të Kushtetutës, është shqyrtuar nga Gjykata edhe nën dritën e nenit 17 të saj, që shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive kushtetuese. Kjo dispozitë përmban detyrimin për të respektuar kriteret e kufizimit vetëm me anë të ligjit, interesit publik dhe ekzistencës së raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë (*shih vendimet nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 17, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në këtë pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike përfshin edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Ky detyrim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave disiplinohet ushtrimi i veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë ose fusha të caktuara. Në këtë rast shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimet 60, datë 31.7.2017; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se dispozita ligjore e kundërshtuar është pjesë e ligjit nr. 32/2021, i cili është miratuar nga Kuvendi sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim. Neni 10, pika 8, fjalia e dytë, i ligjit nr. 32/2021, në thelb, rregullon mënyrën e shpërblimit të avokatit, duke përcaktuar vlerat minimale dhe maksimale, për shërbimet që ai ofron në procedurat e dëmshpërblimit nga pasojat e aksidenteve. Në këtë mënyrë është e qartë që ligjvënësi me këtë dispozitë ka vendosur kufizim në lirinë kontraktore të avokatit në ofrimin e shërbimeve në këtë fushë specifike.

28. Për sa i takon arsyet e rëndësishme publike të kufizimit, në rastin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, Gjykata ka pohuar se pranohen si kufizime të arsyeshme nismat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut ose interesave të një shteti social. Parimi i shtetit social, i parashikuar që në Preambulën e Kushtetutës sonë, e përligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private për të mbrojtur interesat e përgjithshme, siç janë kontrolli publik i kostos së jetesës, lufta kundër inflacionit, shtytja dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese, mbrojtja e shtresave të varfra, promovimi i vlerave sociale etj (*shih vendimin nr. 52, datë 5.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masat e ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i këtij aktiviteti të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*shih vendimin nr. 10, datë 19.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa në kontekstin e interesit publik, të përcaktuar si kriter në nenin 17 të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrsesi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen (*shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Po kështu, shërbimi i avokatisë është vlerësuar nga Gjykata për rolin e rëndësishëm që ai ka në një shoqëri demokratike për të garantuar shtetin e së drejtës, si dhe për të siguruar një mbrojtje eficiente të të drejtave të njeriut. Në një sërë dokumentesh ndërkombëtare vihet theksi në pavarësinë e avokatit nga shteti dhe në rëndësinë e vetërregullimit të këtij profesioni. Për këto arsye, avokazia, si profesion i lirë dhe jo në varësi shtetërore, iu nënshtrohet parimeve të integritetit moral,

konfidencialitetit, respektit për rregullat e etikës, eliminimit të konfliktit të interesave, evitimit të veprimtarive të papajtueshme me ushtrimin e pavarur të detyrave të tyre, mbrojtjes së interesave të klientit dhe respektit për gjykatat (*shih vendimin nr. 7, datë 12.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa më lart, Gjykata çmon se organizimi dhe funksionimi i shërbimit të avokatit në përgjithësi, për rrjedhojë edhe rregullat që lidhen me këtë shërbim në procedurat e përfitimit të dëmshpërblimeve nga aksidentet e transportit, mbart interes publik. Pikërisht për shkak të rëndësisë dhe natyrës së këtij shërbimi, ligjvënësi i ka dhënë atij mundësinë dhe tagrat e organizimit dhe të rregullimit autonom, duke e fuqizuar rolin e kërkueses ndër vite, me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive për ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencës, sipas nenit 11 të Kushtetutës. Megjithatë, edhe vetë shteti ka rol rregullues në ushtrimin e kësaj lirie në rastet e procedurave administrative ose gjyqësore kur duhet ofruar mbrojtje e specializuar dhe e detyrueshme për qytetarët, të cilët, për arsye të ndryshme, janë në pozicion vulnerabël. Kështu, jo pa qëllim, në ligjin nr. 55/2018 është parashikuar se kryetari i Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe ministri i Drejtësisë përcaktojnë tarifat referuese të shpërblimit të avokatit, të cilat zbatohen në rastin kur në marrëveshjen me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit nuk është parashikuar mënyrë shpërblimi (*neni 16, pika 3*), ose përcaktimi i shpërblimit me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, në rastin e mbrojtjes së detyrueshme në procesin penal (*neni 16, pika 1, shkrinja "c"*).

31. Lidhur me kriterin e proporcionalitetit, që lidhet me respektimin ose përmbysjen e kushtit të baraspeshës, pra nëse avokatët, që janë anëtarë të kërkueses, janë ngarkuar me një barrë tej shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi publik ose i komunitetit në përgjithësi, Gjykata duhet të analizojë nëse strategjia e ndërhyrjes së ligjvënësit respekton disa kriterë: i. nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se në shqyrtimin e proporcionalitetit, i cili vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes konkrete, duhen mbajtur parasysh një numër faktorësh, të cilët nuk mund të përcaktohen në mënyrë shteruese. Ata ndryshojnë rast pas rasti, në varësi të fakteve të çështjes dhe të natyrës së ndërhyrjes që ka kufizuar të drejtën themelore (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata konstaton se në rastin konkret ballafaqohet detyrimi kushtetues për të respektuar lirinë e veprimtarisë ekonomike të avokatëve, në kuptim të lirisë për të lidhur kontratat e shërbimit sipas tarifave që ata vlerësojnë, nga njëra anë, me interesat e shtetit për miratimin e rregullave për dëmshpërblimin nga pasoja e aksidenteve, pjesë e të cilave janë edhe procedurat me pjesëmarrjen e avokatit, me qëllim kompensimin e drejtë të subjekteve përfituese, nga ana tjetër.

33. Gjykata vëren se ligji nr. 32/2021 është përafëruar pjesërisht me direktivën 2009/103/BE, datë 16 shtator 2009, "Për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe zbatimin e detyrimit për të siguruar një përgjegjësi të tillë" (*direktiva 2009/103/BE*). Ndërkohë, subjektet e interesuara dhe vetë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk paraqitën modele konkrete ose praktika të mira, që atyre iu kanë shërbyer për të justifikuar ndërhyrjen me këtë mjet dhe në këtë masë, por janë mjaftuar me argumentin se gjatë hartimit të projektligjit janë marrë parasysh aktet ligjore të vendeve fqinje, me qëllim standardizimin e legjislacionit vendës.

34. Neni 10 i ligjit nr. 32/2021 përcakton procedurat dhe afatet e dëmshpërblimit financiar nga siguruesi përgjegjës për personat që kanë pësuar pasoja nga aksidentet. Procedura fillon nga siguruesi me kërkesë të përfituesit dhe zhvillohet brenda afateve të shkurtra, duke përfshirë edhe pagesën e dëmshpërblimit. Mosrespektimi i afateve përbën shkak për pagimin e interesave për çdo ditë kalendarike vonesë. I dëmtuari ka të drejtën e ankimit në shoqërinë e sigurimit, e cila, gjithashtu,

është e detyruar të veprojnë brenda afateve të shkurtra të përcaktuara nga ligji. Gjithashtu, pjesë e procedurës së parashikuar është edhe e drejta e ankimit në gjykatë, në rastet kur i dëmtuari nuk merr përgjigje nga shoqëria e sigurimit për kërkesën e tij brenda afatit, kur nuk është dakord me shkaqet e refuzimit të dëmshpërblimit ose me masën e dëmshpërblimit. Përfituesit e dëmshpërblimit, sipas dëshirës, mund të mbrohen në këto lloj procedurash nga mbrojtësi ligjor i zgjedhur prej tyre. Në këtë rast, mbrojtësi ligjor do të paguhet për shërbimin e ofruar në masën jo më shumë se 5% e vlerës së dëmshpërblimit që individi i mbrojtur prej tij ka përfutur nga shoqëria e sigurimit.

35. Gjithashtu, ligji ka parashikuar se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbikëqyr funksionimin e sistemit të dëmshpërblimit dhe rregullat e ndjekura nga shoqëritë e sigurimit, për të garantuar mbrojtjen e të siguruarve, kryerjen me korrektësi të procedurave të dëmshpërblimit, licencimin e vlerësuesit që bën përlllogaritjen e shumës së dëmshpërblimit sipas parimeve dhe metodologjisë së miratuar nga Autoriteti, duke zbatuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi (*neni 11, pikat 2, 3 dhe 4*).

36. Në mendimin me shkrim të paraqitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si nismëtari dhe hartuesi i ligjit nr. 32/2021, është parashtruar se neni 10, pika 8, fjalë e dytë, për përcaktimin e tarifave të avokatëve, është përfshirë në ligj gjatë procesit të konsultimit me palët e interesuara, me argumentin se në praktikë janë konstatuar raste abuzive të pagesave të larta të mbrojtësit ligjor, që ka cenuar vlerën e dëmshpërblimit dhe të drejtën për përfitim të njohur nga ligji. Sipas Autoritetit, tavan i tarifës 5% i vlerës së dëmshpërblimit është masë krejtësisht proporcionale, pasi ka qëllim të përligjur, është në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë dhe qëllimi i synuar e justifikon. Parimi i drejtësisë kërkon që të merren në konsideratë interesat e të dëmtuarve/trashëgimtarëve të tyre, si dhe interesi publik në tërësi. Dispozita e kundërshtuar nuk cenon lirinë e mbrojtësit të negociojë me palën e përfaqësuar prej tij, si dhe të caktojë shpërblimin që e gjykon të drejtë për shërbimin e ofruar. Përcaktimi i tavanit “jo më shumë se 5%” dhe dyshemesë “jo më pak se tarifat e përcaktuara në aktet përkatëse” të shpërblimit të mbrojtësit, ka për qëllim ruajtjen e pacenueshmërisë së dëmshpërblimit dhe të së drejtës së palës përfituese. Përcaktimi i kufijve të limitit të përgjegjësisë është bazuar në direktivën 2009/103/BE dhe në frymën e jurisprudencës kushtetuese.

37. Duke iu referuar përmbajtjes së dispozitës ligjore të kundërshtuar, në raport me shpjegimet dhe argumentet e paraqitura nga të gjitha palët në gjykim, Gjykata vëren se nuk u paraqitën argumente të qarta dhe bindëse se si është arritur në përfundimin që masa tavan prej 5 % nuk është më e ashpër se sa duhet për të arritur objektivin e mbrojtjes së qytetarëve që çmojnë të marrin shërbimin e avokatit në procedurat e dëmshpërblimit në raport me efektet që ky kufizim sjell te liria ekonomike e avokatëve. Paqartësia për qëllimin e ligjit shtohet po t’i referohemi edhe *travaux préparatoires* të miratimit të tij. Konkretisht, referuar përmbajtjes së relacionit shpjegues të projektligjit, konstatohet mungesa e arsytimit të përlligjjes së caktimit konkret të tavanit 5%. Edhe nga përmbajtja e dokumenteve parlamentare për shqyrtimin e projektligjit, konstatohet se është diskutuar përputhshmëria e tij me ligjin për avokatinë, ndërmjetësimin dhe ligjin e ndihmës juridike falas, të cilat rregullojnë në mënyrë të posaçme marrëdhënien ndërmjet avokatit dhe klientit. Kështu, sipas procesverbalit të datës 11.3.2021 të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ky i fundit ka sugjeruar që Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, të hiqte fjalinë e dytë të pikës 8 të nenit 10 ose ta zëvendësonte me teknikë reference “sipas legjislacionit përkatës në fuqi”.

38. Për më tepër, Gjykata konstaton se direktiva 2009/103/BE nuk rezulton të ketë përcaktuar orientime për kufizime lidhur me tarifat e mbrojtësve. Me fjalë të tjera, subjektet e interesuara nuk provuan para Gjykatës që masa e vendosur të jetë e lidhur në mënyrë të arsyeshme me objektivin që ligjvënësi ka synuar të përmbushë.

39. Gjykata çmon të theksojë se qarkullimi i mjeteve motorike lidhet drejtpërdrejt me lirinë themelore të lëvizjes dhe ushtrohet brenda territorit të kontrolluar nga shteti, për rrjedhojë rregullat

e ligjit nr. 32/2021 për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit janë të rëndësishme për të garantuar paprekshmërinë e jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve, dhe përfshijnë edhe zhdëmtimin e tyre me shpërblim monetar, sipas skemës së përcaktuar nga vetë ligji. Në këtë drejtim, garantimi i së drejtës të personave të dëmtuar dhe trashëgimtarëve të viktimave për të përfituar dëmshpërblimin e plotë dhe të drejtë, sipas përcaktimit ligjor, duhet dhe mbetet objektivi bazë i të gjitha institucioneve të përfshira në procesin e përlllogaritjes dhe dhënies së përfitimit, veçanërisht i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky institucion ka përgjegjësinë ligjore për funksionimin e sistemit të dëmshpërblimit dhe rregullat e ndjekura nga shoqëritë e sigurimit për të garantuar mbrojtjen e të siguruarve dhe kryerjen me korrektësi të procedurave të dëmshpërblimit.

40. Gjykata vëren se argumentet për përlligjen e masës 5 %, që janë paraqitur nga subjektet e interesuara iu referohen në përgjithësi praktikave abuzive të mbrojtësve, por pa u mbështetur në tregues domethënës të tyre, në kuptimin se sa raste të tilla janë raportuar në strukturat mbikëqyrëse të veprimtarisë së avokatëve dhe cilat janë masat e marra në këtë drejtim. Për më tepër, argumenti i subjektit të interesuar se për shkak të kësaj dispozite të re ligjore tashmë rastet zgjidhen me mirëkuptim me të dëmtuarit dhe se vetëm 1% e tyre shkojnë në gjykatë, jo vetëm që nuk është tregues i proporcionalitetit të dispozitës ligjore, por ngre dyshime për pamundësinë e qytetarëve për t'u mbrojtur në mënyrë të specializuar në këto procedura. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se neni 10 i ligjit nr. 32/2021, ndër të tjera, parashikon se ekzekutimi i vlerës së dëmshpërblimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm dhe deklarimi formal i pranimit të vlerës nga pala e dëmtuar ose përfituese, shuajnë përfundimisht detyrimin e shoqërisë së sigurimit (*pika 9, fjalia e parë*). Pala përfituese e dëmshpërblimit nuk ka të drejtë të kërkojë vlerë tjetër dëmshpërblimi, të ndryshme nga ajo që ka pranuar me vullnet të lirë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes dhe/ose deklaratës së pranimit të vlerës (*pika 9, fjalia e dytë*).

41. Nga analiza e përmbajtjes së ligjit nr. 32/2021, Gjykata vëren se ai nuk parashikon mbrojtje të detyrueshme për individët që aplikojnë në këto procedura dhe as nuk parashikon që shpërblimi i avokatit është pjesë e shumës së dëmshpërblimit që paguhet nga shoqëritë e sigurimit drejtpërdrejt te mbrojtësi. Shpërblimi i avokatit në këto raste është tarifë për shërbimin e ofruar prej tij në çështjet që lidhen me fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Në thelb, përcaktimi i pagesës për avokatin deri në 5% të masës së dëmshpërblimit nuk rezulton të jetë i vetmi mjet i arsyeshëm nëpërmjet të cilit ligjvënësi të realizojë objektivin e tij, pra për të parandaluar abuzimin me tarifat e avokatëve në raport me përfituesit e këtij dëmshpërblimi. Subjektet e interesuara, ndonëse u shprehën se dispozita garanton të drejtat e përfituesve, nuk paraqitën argumente bindëse se pse është zgjedhur pikërisht masa 5% dhe pse kjo përbën mjetin e vetëm dhe vlerën e përshtatshme për të reduktuar dhe eliminuar praktikën abuzive të avokatëve në këto çështje.

42. Gjithashtu, Gjykata konstaton se ligji nr. 32/2021 ka gjetur një mënyrë tjetër të caktimit të shpërblimit të avokatëve, duke vendosur masën tavan, në ndryshim nga mënyrat e përcaktuara nga ligji i posaçëm nr. 55/2018, pavarësisht se ky i fundit është miratuar më herët në kohë se ligji nr. 32/2021, objekt kundërshtimi. Kështu, mënyrat e shpërblimit të avokatit, pa iu referuar fushave specifike të shërbimit, përcaktohen në ligjin nr. 55/2018, si pjesë e rregullave për organizimin dhe funksionimin e profesionit të avokatit. Neni 16 i këtij ligji parashikon se shpërblimi i avokatit caktohet: a) me marrëveshje ndërmjet avokatit dhe klientit; b) në përputhje me parashikimet e legjislacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti; c) me udhëzim të përbashkët të ministrave përgjegjës, pasi të jetë marrë paraprakisht mendimi i Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë; ç) me tarifë suksesi, e përcaktuar me marrëveshje të lidhur paraprakisht ndërmjet avokatit dhe klientit; d) çdo shpërblim tjetër i parashikuar në aktet dhe praktikën e organizmave ndërkombëtarë, ku Shqipëria aderon. Në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se shpërblimi i avokatit nuk mund të kryhet në mënyra të tjera, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë nen. Në këtë situatë, Gjykata vëren se ndonëse ligjvënësi ka lirinë për të identifikuar ligjin ku duhet ndërhyrë, ai duhet të përpiqet të mos krijojë paqartësi, për të shmangur barrën e panevojshme te subjektet që iu drejtohet ligji.

43. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se dispozita e kundërshtuar ndërhyr në lirinë ekonomike, në aspektin e lirisë kontraktore të avokatëve, që garantohet nga neni 11 i Kushtetutës dhe ndonëse ndërhyrja është bërë me ligj dhe për interes publik, në gjykim nuk rezultoi që ajo të respektojte parimin e proporcionalitetit siç kërkon neni 17 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësës për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i bazuar.¹

44. Në kushtet kur dispozita ligjore e kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi nuk respekton lirinë ekonomike të avokatëve për shkak të ndërhyrjes joproporcionale që ajo bën, Gjykata çmon se është i panevojshëm shqyrtimi i pretendimit tjetër për cenimin e parimit të mosdiskriminimit në marrëdhëniet ekonomike.

45. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa sipas arsytimit të mësipërm është e bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “d”, 51/a, pika 1, shkronja “b” dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e fjalisë së dytë në pikën 8 të nenit 10 të ligjit nr. 32/2021, datë 16.3.2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.12.2022.

Shpallur më 29.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska

Anëtar kundër: Sandër Beci

¹ Gjyqtari Sandër Beci votoi kundër pranimin të pretendimit të kërkuësës, me argumentin se ndërhyrja në lirinë ekonomike, në aspektin e lirisë kontraktore të avokatëve, është proporcionale.